


BUXHETI, PLANIFIKIMI I PROKURIMIT DHE PRAKTIKAT NË KOMUNAT E PRIZRENIT, SUHAREKËS, FERIZAJT, LIPJANIT, PODUJEVËS DHE ISTOGUT



01 Komunat u ishin përmbajtur afateve ligjore për hartimin dhe aprovimin e buxhetit dhe planifikimit të prokurimit.

03 Vlera e prokurimeve për investime kapitale tejkalonte vlerat e buxhetuara sipas ligjit të buxhetit për afër **2.7 MILION EURO.**

Tejkalimet më të mëdha buxhetore ishin vërejtur tek komunat e Podujevës dhe Istogut. Këto tejkalime buxhetore do të thonë se komuna rrezikon të hyjë në detyrime të cilat nuk ka fonde për t'i mbuluar.



02 Vonesat në aprovimin e Ligjit për buxhetin kishin ndikuar në vonesa lidhur me fillimin e procedurave të prokurimit në gjashtë komunat e monitoruara.

04 Ferizaj dhe Istogu nuk kishin bërë planifikime të prokurimit për shënim të festave dhe përvjetorëve gjatë vitit 2019, përderia Prizreni, Suhareka, Lipjani dhe Podujeva kishin bërë planifikime të tilla.



06 Në mostrat e analizuar (10 tenderët e parë për furnizime të shpallur nga secila komunë në vitin 2019), **77%** e vlerave dhe sasive të tenderuara **nuk përputhen** me ato të planifikuara.



05 Ferizaj dhe Lipjani kishin bërë ndarje të kërkesave të natyrës së njëjtë, që nënkupton **shmangie nga procedurat** e rregullta të prokurimeve të vlerave më të larta.

07 **18%** e tenderëve të analizuar për 2019 **nuk ishin** fare në planifikimet e komunave.

